

NJË HISTORI E VETME?

Talal Asad *

(www.openDemocracy.net: 5 maj 2006) – *Mbrojtja që Francis Fukuyama ia bën universalizmit të vlerave e institucioneve perëndimore po sfidohet nga realitetet moderne globale politike, thotë Talal Asad.*

Ndoshta tipari më goditës i pasthënies së Fukujamës që ia bën botimit të dytë të librit të tij *The End of History and the Last Man* është koncepti i tij për një histori të vetme dhe unike të njerëzimit – njëkohësisht edhe universale edhe e shumëpjestshme (multiple). Pyetja: “Ç’ e lidh shumëllojshmërinë e popujve e të kulturave në një histori të vetme?” në të vërtetë është një temë kyçe në historinë intelektuale dhe ka gjetur përgjigjen nga Hegeli e nga mendimtarë të mëvonshëm me pretendimin se ajo është shoqëria perëndimore e cila e përfaqëson të ardhmen e të gjitha të tjerave që nuk kanë pasur fatin të vdesin.

S’jam i sigurt se kuptoj çfarë dëshiron të thotë Fukujama kur pyet nëse vlerat dhe institucionet perëndimore kanë “rëndësi e kuptim universal” dhe kur ai këtë e vë përballë termit “sukses i përkohshëm i një kulture të sotshme hegjemoniste”. Është e qartë se këto vlera e institucione *kanë* rëndësi e peshë universale nëse ai me këtë nënkupton se ato janë përhapur në nivel global – qoftë me konsensus ose pa të. Mirëpo kjo nuk e përjashton mundësinë që “rëndësia universale” të shihet si produkt i një kulture të fortë e hegjemonizuese. Theksimi se me rënien e komunizmit demokracia kapitaliste tani mbetet e ardhmja e vetme *e imagjinueshme* për njerëzimin, nuk provon se nuk mund të dalë asgjë e re. Meqë asgjë nuk është permanente, është më se e mundshme që kjo kulturë politike hegjemoniste të shndërrohet e

të marrë formën e një tjetre, njësoj hegjemoniste (kjo, nëse në shekullin e ardhshëm do të kemi akoma një planet të përshtatshëm për njerëzit).

Ajo çka është interesante për esenë e Fukujamës, megjithëkëtë, nuk është kontributi i tij dhënë debatit për kulturën, porse pohimi se shoqëri të ndryshme njerëzore po garojnë drejt një fundi pak a shumë të njohshëm dhe se suksesi apo dështimi relativ i secilit garues duhet kërkuar në përbërjen dhe natyrën e tij të brendshme. Ekziston një literaturë e bollshme e cila i demonstroi interaksionet (ndërveprimet) komplekse ndërmjet entiteteve politike-ekonomike – shtetet sovraane që nuk i kontrollojnë fatet sovraane – mirëpo eseja e Fukujamës nuk adresohet në këtë lëndë.

Rrënjët e demokracisë

Fukujama, ashtu si edhe të tjerët, “demokracinë moderne” e lidh me doktrinën krishtere të “dinjitetit universal të njeriut”. Mua më duket kjo e tepërt, ngase në latinishten e Mesjetës fjala *dignitas* i është referuar privilegjit të zyrës së lartë, e jo barazisë politike. Krishterimi ka pasur një nocion të vlerës shpirtërore universale, mirëpo kjo gjithnjë ka qenë në pajtueshmëri me pabarazinë e madhe sociale dhe politike.

Për shumicën e shkrimtarëve rrënjët e demokracisë moderne shtrihen jo në Krishterim, porse në Greqinë klasike. Athina parakrishtere sigurisht që ka pasur një koncept (të kufizuar) për qytetari të barabartë dhe praktika demokratike (bazike), mirëpo nuk e ka pasur nocionin “dinjiteti universal i njeriut”. Kjo sugjeron se demokracia shekullare moderne – e cila gradualisht, përmes luftës, e ka zëvendësuar pabarazinë krishtere në Perëndim – nuk mbështetet në vlerë, siç pohon shpesh Fukujama dhe të tjerët. Ajo në çka mbështetet është *përfaqësimi* i një individi ndaj një tjetri: secili votues llogaritet si një dhe jo më tepër se një në aritmetikën e demokracisë.

Nëse jo dinjiteti atëherë ndofta lumturia? Fukujama pretendon epërsinë e demokracisë kapitaliste duke e vënë shenjën në shumë njerëz të cilët migrojnë në vendet e pasura të veriut “për shkak se ata shohin se mundësitë për lumturinë njerëzore janë më të mëdha në një shoqëri të pasur sesa në një të varfër”. Shumica dërmuese e popullatës botërore akoma nuk lëviz; imigrantët për në shoqëritë perëndimore përbëjnë një përqindje tejet të vogël në krahasim me popujt joperëndimorë. A thua ata që e kanë frenuar vetveten duhet t’i shikojmë si njerëz që nuk kanë koncept për “lumturinë njerëzore”?

Sigurisht që motivet për migrim shpesh janë të komplikuar. Ato e përfshijnë dëshirën për të ikur nga kushtet e rrezikshme politike sa edhe dëshirën për të fituar para jashtë e për t’ua dërguar të afërmeve të tyre në shtëpi, sesa thjesht nga dëshira për lumturi. E të mos e përmendim faktin se ëndrrat për gjetjen e “lumturisë” nuk korrespondojnë gjithëherë me realitetin të cilin e takojnë shumica e imigrantëve (ose edhe e qytetarëve vendas) në demokracitë kapitaliste.

E ardhmja e demokracisë

Dyshime paraqiten edhe në konceptimin e Fukujamës për “të ardhmen e demokracisë” në botën joperëndimore. Le të supozojmë për hir të argumentit se demokracia që e përfytyron Fukujama është diçka të cilën e dëshiron

gjithkush: e lidhur ngushtë me një regjim neo-liberal “që premtonte lumturinë universale” dhe e cila po ashtu është domosdo “shekullare”. Doktrina krishtere, sipas tezës tejet të lashtë, e ka përkapur demokracinë sepse kisha dhe shteti kanë filluar si dy entitete të ndara. Historikisht kjo është e pasaktë, sepse shteti-kishë bizantine ka qenë baza mbi të cilën janë formuluar doktrinat qendrore krishtere. Madje edhe në Evropën e Mesjetës “kjo ndarje nuk ka qenë kurrë e domosdoshme ose complete”, siç thotë Fukujama. Tani e njëjta mund të thuhet edhe për historinë islame (që është një temë shumë e gjatë të cilën nuk mund ta diskutojmë këtu).

Argumenti alternativ është që të mos i kushtohet vëmendje origjinës historike por skenës bashkëkohore, dhe jo se demokracia mungon vetëm në botën myslimane. Ç’është pengesa? Është kjo Islami? (Arsyetimi i gabuar këtu është se *mungesa* merret për *paafësi*.) Fukujama mendon se disa vende myslimane janë duke përjetuar një kalim drejt prosperitetit ekonomik dhe demokracisë politike dhe kështu na sugjeron se fajtor nuk është Islami porse “kultura politike arabe”.

Mirëpo merre në konsideratë me këtë rast fitoren në zgjedhje të Hamasit në Palestinën e okupuar në janar të 2006 – një formim demokratik që u minua nga Bashkimi Evropian dhe nga ShBA-të, pra nga modelet e së ardhmes demokratike liberale të njerëzimit. Ka përjashtime, natyrisht, mirëpo përjashtimet mbeten përjashtime. Duket qartë se te këto qeveri ka shumë më tepër shqetësim për “sigurinë e Izraelit” sesa për të ardhmen e palestinezëve.

Në një artikull të vitit 2004 të botuar në *National Interest* me titull “The Neoconservative moment”, Fukujama e përshkruan Izraelin si “një vend i vogël, i lëndueshëm dhe i rrethuar me armiq të paepur”. Megjithatë Izraeli është dukshëm shteti më i fortë (si dhe më demokratik) në regjion, i vetmi në rajon që zotëron armë bërthamore; ai lehtë e ka fituar çdo luftë me fqinjët e tij, i ka zgjeruar territoret e tij, ka fituar një njohje të gjerë ndërkombëtare si dhe ka lidhur marrëveshje paqeje me dy

shtete arabe dhe me shumë të tjera në proces e sipër. Jo që asnjëherë nuk e ka njohur formalisht të drejtën e palestinezëve për ta krijuar shtetin e tyre në gjithë ato toka të grabitura prej tyre, por ai vazhdon në mënyrë të pakontrolluar që dhunshëm të krijojë kushte të cilat do ta bënin të pamundshëm shtetin e ardhshëm palestinez.

Pikërisht lidhur me këtë unë po e theksoj deklarinimin më të rëndësishëm në gjithë esenë

e Fukujamës: “Nuk ka arsye të mendojmë se demokracitë liberale sovrane nuk mund të bëjnë abuzime të llahtarshme në marrëdhëniet me kombet e tjera, ose madje me respekt edhe me vetë qytetarët e tyre”. Përfaqësuesve të universalizmit (parimisht ShBA-ve dhe BE-së) këto abuzime duhet t’u duken si domosdoshmëri të papëlqyeshme të menaxhimit global “realist”.

* * *

* Talal Asad është profesor nderi i antropologjisë në CUNY Graduate Center në Nju Jork. Ndër librat e tij bëjnë pjesë: *Genealogies of Religion: Discipline and Reasons of Power in Christianity and Islam* dhe *Formations of the Secular: Christianity, Islam, Modernity*. Punimi i tij është lëndë e një përmbledhjeje esesh të edituar nga David Scott & Charles Hirschkind *Powers of the Secular Modern: Talal Asad and His Interlocutors*.

Nga anglishtja:
mr. Rejhan Neziri